

TEUTA SULA

**RRUGËTIME SHQIPTARE E A. BALDAÇIT:
TIPOLOGJI UDHËPËRSHKRIMI**

Ç'është libri i udhëtimit sot? Një libër i hapur, një navigator digjital a satelitor, që ka integruar në venat e veta edhe shtegëtimet e rrugëtarëve historikë.

Tekstet e udhëtimit janë një zhanër që po tërheq gjithnjë e më shumë vëmendjen e studiuesve, më së shumti, për shkak të kryqëzimeve të disiplinave e ligjërimeve të ndryshme. Si tekste të ndërmjetme¹ mes etnografisë, antropologjisë e letërsisë, mes ligjërimit subjektiv e atij objektiv, këto lloj shkrimesh bashkëndajnë kufij me gjeografinë, botanikën, religjionin, historinë, artet etj. Ripërkufizimi i udhëtimit si shkencë e art i përshkrimit, ka pësuar ndryshime në literaturën e udhëtimit. Në varësi të funksionit ligjërimor, tekstet udhëpërshkruese ndahen në udhëpërshkrime fizike, të cilat merren me përshkrimin e itinerarit të kryer fizikisht prej subjektit dhe tekste udhëpërshkrimi artistik, të cilat rrëfejnë udhëtimin imagjinar. Të parat kanë karakter shumë më objektiv se udhëtimet artistike; ato nisin si misione kërkimi shkencor, misione diplomatike, ushtarake, fetare etj., e ngjizen si vëzhgime racionale të subjektit/misionarit/autorit me vendin dhe popullin e huaj. Udhëtari i vërtetë nuk tregon më gjëra të pabesueshme, histori të vendeve të largëta dhe monstruozitete, por, sipas këndvështrimit të vet, mbledh e verifikon materialin, pranon kufizimet dhe njëanshmëritë e

¹ Shih: Gnisci, Sinopoli, Trocchi. *Letteratura Comparata*. - Milano, Mondadori, 2002.

përvojës pararendëse, korrigjon gabimet e tyre dhe ofron kontributet vetjake.

Në këto raste vërtetësia e tekstit vlerësohet bazuar në përputhshmërinë e tij me të dhënat e përvojës. Tipar kryesor është “informacioni”, “e dhëna”, që presupozon perspektivën e vëzhguesit. Në periudha të hershme të qytetërimit, në epokën preindustriale, një nga mjetet kryesore për të hulumtuar realitetin mbetet udhëtimi. Për vende të vogla, si vendi ynë, shkrimet e udhëtimit kanë qenë themeltare në ndërtimin e dijeve albanologjike. Nga ana tjetër, udhëtimet artistike dallohen për ligjërimin fikcional e letraritetin, ku kufiri mes artit dhe shkencës është i rrëshqitshëm e fluid, kështu tekstet e udhëtimit receptohen njëherazi si përshkrime subjektive e letrare e më pak si tekste objektive e shkencore.

Ndër udhëtarët italianë, që vizituan Shqipërinë në fund të shekullit XIX e në fillim të shek. XX, vend të veçantë për larminë e ekspeditave dhe teksteve udhëpërshkruese zë Antonio Baldaçi, i cili la një sërë studimesh shkencore në fushë të botanikës, historisë, gjeografisë, dokeve e zakoneve, politikës, ekonomisë etj. Tipologjia e teksteve udhëpërshkruese të Baldaçit mund të hulumtohet përmes kontakteve me “Tjetrin”, vendin e gjuhën e huaj po aq sa dhe komunitetin e kulturën e huaj. Këndvështrimi i Baldaçit për “Tjetrin”, të panjohurin, që pret të eksplorohet si i ndryshëm nga “Vetja”, realizohet më shumë në rrafsh të ligjëritit objektiv e më pak në atë shkencor. Shqipëria e asaj kohe, në perceptim thuajse ekzotik të raporteve të europianit të qytetëruar e vendeve të prapambetura lindore, që ofrojnë zbulim thesaresh – për autorin – cilësohej si “*Evropa fare e panjohur*”. Tiparet e natyrës sonë malore, Baldaçi i gjen përputhshëm me tipat njerëzorë, si shprehet ai: “Natyra gëlqerore karstike, që mbulon një vend me male si ky, nuk mund veçse të strehonte njerëz të gatshëm për të mos lejuar elementë të huaj”. Koncepti i udhëtimit qëllimor objektiv me vëzhgime të drejtpërdrejta për botën përfshinte edhe mbështetjen në përvojën kërkimore të studiuesve të mëparshëm, që na vjen përmes citimesh e referimesh autorësh e librash të tjerë, të cilët përfaqësojnë përvoja, vëzhgime, studime e konkluzione të rëndësishme. Baldaçi i referohet shpesh Majerit dhe mbështet idetë e tij si në rastin:

“Prandaj, sipas mendimit tim, është i drejtë mendimi i Mayer-it, sipas të cilit vendi i Malit të Zi paraqitet identik me atë të Malësisë shqiptare. Dhe për këtë arsye e njëjta racë duhet të ketë sunduar *ab antiquo* në rajonin labeatik, aq më tepër që vetëm një grykë mbi liqenin e Shkodrës e bashkonte këtë racë me qendrat tregtare të kohëve greke dhe romake, të cilave ajo ishte e detyruar tu shërbente”². Po kaq interesant vjen në tekst theksimi i konkluzioneve të kërkimeve gjuhësore të G. Majerit mbi trashëgiminë leksikore (400 fjalë) të fondit indoevropian ilir³. Po kështu, ai i referohet Nopçes e Tragerit kur shënon se: “Nopça dhe Trager, që janë marrë me prejardhjen e shqiptarëve bashkëkohorë, pyesin, duke ndjekur mendimin e antropologëve, që kanë shtuar këto kohët e fundit një racë të zeshkët alpine, nëse shqiptarët e veriut e kanë prejardhjen nga një racë alpino-ilirike, e prejardhur nga veriu, ose, si do të donin të tjerët, një racë thrako-anatolike e ndërfutur nga lindja”⁴.

Udhëtimet e Baldaçit fillimisht kishin karakter thjesht shkencor dhe i kushtoheshin eksplorimit botanik, duke e pasuruar me shumë lloje të reja florën e vendit tonë. Koleksione të shumta botanike, të përgatitura nga Baldaçi, përbëjnë ende sot thesarin e çmuar të muzeve të huaja në Londër, Paris, Vjenë etj. Me kalimin e kohës, synimet e Baldaçit u bënë gjithnjë e më të gjera. Nga përvoja e fituar, ai kuptonte rëndësinë territoriale të vendit tonë që në kohën e sundimit turk “*ishte tmerrësisht e vështirë për t’u përshkuar*” dhe politikën e Italisë ndaj Adriatikut. Si filoitalian, Baldaçi u bë mbrojtës i zjarrtë i idesë italiane të “Mare nostro”-s, sipas së cilës Shqipëria e pavarur nuk do të ishte e mundur veçse nën mbrojtjen e Italisë. Mbrojtës i idesë se Italia ishte e vetmja fuqi që mund të

² A. Baldacci, *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. - Tiranë, Argeta-LMG, 2006, f. 35.

³ “G. Meyer besoi se mund të vërtetonte, me një farë sigurie, se nga 5140 zëra shqipe të mbledhura prej tij, dhe që janë në krye të fjalorit të tij, “vetëm rreth 400 i takojnë trashëgimisë së lashtë indogjermanike”, ose indoevropiane, ose arianoevropiane, që do të thotë ilirike”. Po aty, f. 45.

⁴ A. Baldacci, *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. - Tiranë, Argeta-LMG, 2006, f. 39.

mbronte Shqipërinë nga lakmitë e fqinjëve, Baldaçi shënonte se në sajë të “ndihmës të gjerë politike, financiare dhe teknike të Italisë Shqipëria mundi të ripërtërihej me shpejtësi këto vitet e fundit. [...] Italia kërkoi lumturisht të sigurate pavarësinë politike, stabilitetin financiar e rimëkëmbjen ekonomike të shtetit të ri. [...] Nga kjo sakrificë jo e lehtë Italia nuk pret përfitime të tjera për vete përveçse sigurinë shqiptare dhe marrëdhënie më të ngushta ekonomike dhe tregtare midis dy brigjeve të Adriatikut”⁵.

Vëmendja e tij u drejtua gjithmonë drejt viseve të Ballkanit. Ndër udhëtimet e tij të para përmendim atë të Dalmacisë e Malit të Zi, ku studioi nga afër florën e këtyre vendeve. Nga viti 1888 e drejtoi vëmendjen në Shqipëri e në Greqi, flora e së cilës ishte çelësi për të kuptuar raportet fitogjeografike (gjeografia e botanikës) midis Italisë dhe vendeve ballkanike, Azisë së Vogël dhe Afrikës Veriore. Ndihma modeste që i dha Françesko Krispi i bëri të mundur vazhdimin e kërkimeve në Shqipëri, veçanërisht në zonën e malit të Tomorit. Me kalimin e kohës, synimet e Baldaçit u bënë gjithnjë e më të gjera. Periudha kur Baldaçi shërbeu si Këshilltar Civil pranë Komandës së Lartë në Vlorë i shërbeu shumë për të njohur territorin dhe banorët e vendit.

Para se t’i botonte si vepra të veçanta, autori kishte filluar t’i prezantonte rezultatet kryesore të nxjerra nga udhëtimet e eksplorimit si trajtesa studimore që më 1890-n. *Itinerari Albanesi (Rrugëtime shqiptare, 1892–1902)*, botuar më 1917-n, është libri i parë i tij për vendin tonë, i cili u prit shumë mirë dhe u shit në një kohë fare të shkurtër në Itali.

Monografia kushtuar Shqipërisë titulluar *Albania*, 1929, përgatitur për Institutin Gjeografik Ushtarak Italian, për shkak të larmisë së përmbajtjes, merr trajta të traktatit politik.

Ekspeditat e shumta kërkimore të Baldaçit u përmbledhën në veprën e titulluar *Studi specialit Albanesi*, botuar në Romë në vitet 1932, 1933, 1937. Lënda e saj ndahet në tri pjesë kryesore të pavarura: 1. historiko-politike, 2. ekonomike, 3. shkencore.

⁵ A. Baldacci, *Shqipëria e Madhe*. - Tiranë, Uegen, 2006, f. 12.

Duke e evidentuar si një nga përfaqësuesit më të rëndësishëm të udhëtarëve dhe udhëpërshkrimeve të periudhës në fjalë, i konsiderojmë shumë të rëndësishme tekstet e udhëtimit të Baldaçit. Ato përfaqësojnë përvoja “zbulimi” dhe kontribuan mjaft në lindjen e shkencës moderne si një disiplinë e bazuar te vëzhgimi⁶, që presupozon ndarjen e qartë të subjektit nga objekti. Kryevepra monumentale e Baldaçit, siç cilësohet prej studiuesve, përmban “më se 100 mijë ekzemplarë bimësh shqiptare ... ndër këto bimë një 50 janë zbuluar prej vetë Baldaçit”.⁷

Duke ndjekur qëllimin e udhëtimit, botën e bimësisë, duke mbledhur mostra e duke bërë gjenealogji për vitrinat e tyre, Baldaçi na la një mori “të dhënash”, që ndikuan në modernizimin e shkencës së botanikës. Shkenca moderne ngrihet në një kontekst në të cilin evropianët bëhen udhëtarë të vetëdijshëm brenda dhe jashtë kufijve të një qytetërimi, hulumtojnë e zbulojnë rregullsi të caktuara në kontekstin e përvojës ku përfshihen.⁸

Në veprën e parë, *Rrugëtime shqiptare*, Baldaçi shkruan “Në gjirin e Shqipërisë nuk më tërhoqën vetëm kërkimet botanike: etja për të studiuar këtë pinjoll të fortë të mbijetuar të pemës së madhe etnike të Adriatikut, i veçuar dhe karakteristik në gjendjen e tij shoqërore primitive, më udhëhoqi në të gjitha udhëtimet shqiptare, por pa mëtuar, siç është e natyrshme për një botanist, për t’i dhënë një zgjidhje këtij problemi shumë intrigues, rreth të cilit as historianët, as etnografët, as arkeologët, as sociologët nuk ia kanë dalë deri më sot të kënaqin shpresat tona”⁹.

Theksojmë se tekstet udhëpërshkruese kanë shërbyer si burime të mira njohëse për vende dhe popuj të ndryshëm; përmes tyre

⁶ E. J. Leed, *La mente del viaggiatore: dall’ Odissea al turismo globale*. - Bologna, Il Mulino, 1992.

⁷ Baldacci, Antonio. *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. - Tiranë, Argeta-LMG, 2006, f. 19.

⁸ E. J. Leed, *La mente del viaggiatore: dall’ Odissea al turismo globale*. - Bologna, Il Mulino, 1992. Shih dhe T. Todorov, *Konkista e Amerikës: çështja e "tjetrit"*. - Tiranë, Pika pa sipërfaqe, 2015.

⁹ A. Baldacci, *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. - Tiranë, Argeta-LMG, 2006, f. 31.

krijohej imazhi i vendit dhe popullit për të cilin flisnin. Baldaçi e identifikon Shqipërinë si një “nga vendet e thella afrikane, sepse askush, as qeveria, as banorët, duke ndjekur zakonet orientale, kurrë nuk janë kujdesur për mbarëvajtjen e vendit. ... Krahinat shqiptare me natyrë të pasur, ishin, si dhe sot, një tokë e pashfrytëzyeshme, e përmbetur, pa rrugë ose mjete të tjera komunikimi, një vend që dëshpëronte disa evropianë që e vizitonin. Banorët, që nuk ishin kusarë, krenarë dhe primitivë në të njëjtën kohë, ishin të tmerruar nga hakmarrja, që disa herë asgjësonte fshatra dhe fise të tëra brenda një kohe të shkurtër. Qeveria, e sunduar nga tarafet dhe nga krerët, ishte në një gjendje të mjerë ndërmjet mëshirës dhe urrejtjes; kështu, në mes të gjithë kësaj anarkie, burimet e mrekullueshme të Shqipërisë vazhdonin të humbisnin kot”¹⁰.

Nuk mund të themi nëse imazhi që përcillnin këto studime të bashkëkombësit e Baldaçit përputhej apo jo me përfytyrimet, njohuritë dhe dijenitë që kishin italianët për vendin tonë, por jehona e studimeve të tij dhe përshkrimet për vendin dhe popullin tonë, priteshin nga personalitete shqiptare, të tillë si: Dom Ndoc Nikaj, kështu: “... por sa kthëj n’ dhé t’ Itales i harhoj nnërat e Shqyptarvé é shkroj se ná jéna ñërz t’ éger, ñërz t’ payrnék, t’ pammsim, t’ pabés é ghith shka mujt é dijtí mé sénerghué per né. É kio nnér na ért h préj ñi Italianit, préj ñi asish bélda qí préi atyné qí thirén vlhaznit t’ on i nnerojn é t’ réitun préj tyné na bléjn né préj shkrimësh tyné é na kujtojn t’ shitun Némces, a Myskovit a bélda édhé Malit-Zi. Por Baldaçi i shtrént é sa Baldačia tjer qí shkrujn per né nuk é diftojn ghymértin é Shqyptarvé é bukdhanen t’on. Na é dim sé sa sajdi munnét mé pas ñi i perjashtem n’ dhé t’ Éltinit fis Baldaçias h. Atjé ngorth ûnit kush nuk ka mé hanger préj kulétes vét; atjé nuk shtron kush sofer por ner lokanda, é ñizét vét hân m’ ñi sofer ghithkush n’ hésap t’ vét. É Baldaçi, mmasi ghét ghith kah shkoj sofren é Shqyptarvé t’ shtrumé, na thrét ñërz t’ éger é t’ pa far marifétit n’ védi”¹¹.

¹⁰ A. Baldacci, *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. - Tiranë, Argeta-LMG, 2006, f. 33.

¹¹ “*Albania*”. - Bruksel, 1898, 1–15 gusht, f. 71–72.

Koncepti i ligjëritit objektiv, distanca e supozuar mes vëzhguesit dhe të vëzhguarit, identifikimi i këndvështrimit shkencor si një perspektivë “e jashtme”, vlerësimi dhe referimi i studiuesve pararendës, krijimi i imazhit duke e konceptuar botën si një sistem të hapur e të mbyllur, mbledhja dhe klasifikimi e lëndës së parë bazuar në metodat e vëzhgimit, përpunimi i materialit kërkimor në përpilime statistikore, që luajtën rol në modernizimin e kanonit të shkencave objektive, e që njëtojnë pandashëm edhe qëllimin e dimension kulturor, të gjitha këto korrespondojnë me statusin e udhëtarit të *Rrugëtimeve shqiptare*.

BIBLIOGRAFI

- Baldacci, A., *Rrugëtime shqiptare (1892–1902)*. – Tiranë, Argeta-LMG, 2006.
- Baldacci, A., *Shqipëria e Madhe*. – Tiranë, Uegen, 2006.
- Chevrel, Y., *Letërsia e krahësuar*. – Tiranë, Albin, 2002.
- Elsie, R., *Histori e letërsisë shqiptare*. – Tiranë; Pejë, Dukagjini, 1997.
- Frashëri, M., *Udhëtarët e huaj në Shqipëri gjer në fund të shekullit XIX*. – Tiranë, Eurorilindja, 1999.
- Gnisci, Sinopoli, Trocchi, *Letteratura Comparata*. – Milano, Mondadori, 2002.
- Leed, E. J., *La mente del viaggiatore: dall’ Odissea al turismo globale*. – Bologna, Il Mulino, 1992.
- Todorov, T., *Konkuista e Amerikës: çështja e “tjetrit”* – Tiranë, Pika pa sipërfaqe, 2015.